

## AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

### Pozicionet drejtuese që janë subjekt deklarimi pranë AIDA-s

#### **1. Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s**

Znj. Laura Plaku (Saro) është emëruar Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s me vendimin e Bordit Drejtues nr. 1, datë 14.09.2023. Znj. Plaku është diplomuar në fushën e Drejtësisë pranë Universitetit të Kent, Canterbury, Mbretëria e Bashkuar dhe Universitetit të Kent, Bruksel, Belgjikë. Znj. Plaku zotëron licencën e Avokatit dhe ka një eksperiencë të gjatë në fushën e konsulencës ligjore dhe menaxhimit.

Ndër përvojat e saj të shumta rezulton dhe mësimdhënia në fushën akademike, si dhe ekspertiza ligjore.

Znj. Plaku gjatë eksperiencës të saj 11 vjeçare në fushën e drejtësisë ka ndjekur trajnime dhe kualifikime të shumta.

Znj. Plaku është gjithashtu njohëse e 4 gjuhëve të huaja.

Adresa e-mail: [laura.plaku@aida.gov.al](mailto:laura.plaku@aida.gov.al)

#### **2. Drejtor i Drejtorisë së Investimeve**

Znj. Mileva Meksi është e emëruar në këtë detyrë nga muaji shtator 2019. Ndërkohë që është punonjëse e AIDA-s nga viti 2012, ku ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit After Care, Drejtoria e Investimeve.

Në vitin 2007 ka mbaruar studimet e larta për Drejtësi në Universitetin “Luarasi”, Tiranë. Gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer trajnime të shumta në fushën e jurisprudencës. Me një eksperiencë mbi 15 vjeçare në pozicione të ndryshme në nivel drejtues në institucione publike si koordinator projektesh me fonde te BE, asistent në Kabinetin e Ministrisë të Shëndetësisë, etj. Znj. Meksi është gjithashtu dhe njohëse e tre gjuhëve të huaja.

Adresa e-mail: [mileva.meksi@aida.gov.al](mailto:mileva.meksi@aida.gov.al)

### **3. Drejtor i Drejtorisë së Marketing dhe Kërkim Analizës**

Znj. Dildirus Vrioni është e emëruar në këtë pozicion nga vitin 2019. Znj. Vrioni ka përfunduar studimet e larta në vitin 2008 pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. Gjithashtu është diplomuar në fushën e shkencave politike, master profesional, në Universitetin e Parisit 8, Vincennes Saint – Denis, Francë. Aktualisht është duke ndjekur studimet për mastër shkencor në degën Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, pranë Universitetit të Studimeve Europiane, Tiranë. Znj. Vrioni ka eksperiencë disa vjeçare në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit në sektorin publik. Gjatë eksperiencës të saj të punës 9 vjeçare ka ndjekur trajnime dhe kualifikime të shumta në fushën ku aktualisht është drejtor.

Adresa e-mail: [dildirus.vrioni@aida.gov.al](mailto:dildirus.vrioni@aida.gov.al)

### **4. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse**

Znj. Erisa Ymerali është emëruar në këtë detyrë në muajin shkurt 2023. Në vitin 2008 ka mbaruar studimet e larta në Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Kontabilitet Financë. Ka kryer trajnime të ndryshme në fushën e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar. Me një eksperiencë mbi 15 vjeçare në institucione publike qendrore, në pozicione të ndryshme në nivel drejtues në fushën e menaxhimit të burimeve financiare. Njohëse e dy gjuhëve të huaja.

Adresa e-mail: [erisa.ymerali@aida.gov.al](mailto:erisa.ymerali@aida.gov.al)